



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA V

Komisioni për bujqësi, pylltari, mjedis dhe planifikim hapësinor

Mbledhja nr. 31

Prishtinë, më 3.3.2016, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

i mbledhjes së komisionit për bujqësi, pylltari dhe mjedis e planifikim hapësinor

Në mbledhje morën pjesë : Duda Balje, Adem Salihaj, Murat Hoxha, Srdjan Popoviq, Emilija Redzepi, Shaip Muja.

Munguan : Lahi Brahimaj, Haxhi Shala, Salih Salihu.

Të ftuar dhe pjesmarrës tjerë sipas listës së nënshkrimeve.

Stafi mbështetës i Komisionit : Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Duda Balje**, kryetare e komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 16.2.2016,
3. Shqyrtimi i në parim i Projektligjit për mbrojtjen nga zhurma,
4. Te ndryshme ;

Kryesuesja **Duda Balje** njoftoi komisionin për kryesimin që e mer nga tani si pasojë e rrotacionit të këtij funksioni nga GP 6+ dhe konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës për këtë mbledhje u miratua pa verejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 16.2.2016

Procesverbali 16.2.2016 u miratua pa verejtje.

3. Shqyrtimi në parim i projektligjit për mbrojtjen nga zhurma

Kryesuesja **Duda Balje** lidhur me këtë projektligj tha se projektligji në fjalë është dërguar nga Qeveria pasi që në legjislacionin e kaluar ka mbetur pa u miratuar edhe pse është punuar mjaft si nga ana e komisionit ashtu edhe nga ana e MMPH.

Adem Salihaj uroj punë të mbarë kryetares dhe potencoi se në legjislacionin e kaluar kanë qenë tjerë anëtar të komisionit dhe sugjeroi të formohet një grup punues për të pa se çfarë kanë punuar në këtë projekt, pastaj të procedohet në leximin e parë.

Emilija Redzepi gjithashtu uroj kryetares punë të mbarë dhe ndërhyri në fjalën përshëndetëse të kryetares dhe tha se ish kryetari Fikrim Damka nuk është që nuk ka punuar përkundrazi. Lidhur me këtë projektligj mbështeti formimin e GP çka gjithashtu edhe **Murat Hoxha** ishte për formimin e GP. **Shaip Muja** poashtu tha se është informuar që në legjislacionin e kaluar ky projektligj është përmirësuar 40%, ndaj për të pa se a janë respektua standardet e zërimit në jetën tonë të përditshme, nuk kundërshtoi formimin e GP. Uroi suksese kryetares. Pas propozimeve të bëra kryesuesja propozoi kurse Komisioni mori këtë :

P Ë R F U N D I M

Formohet grupi punues nga : Emilija Redzepi-kryesuese, Shaip Muja-anëtar, Adem Salihaj-anëtar dhe Srdjan Popovic anëtar për të shqyrtuar projektligjin deri në miratimin në parim në Komision për ta përcjellë në mbledhjen plenare gjithashtu për miratim në parim.

4...Të ndryshme

Kryesuesja për këtë pikë propozoi shqyrtime dhe konkluzionet si vijon :

- Lidhur me shkresën e kryesuesit të GP z. **Shaip Muja** rreth projektligjit për Obiliqin dhe të z. **Murat Hoxha**, komisioni debatoi dhe konstatoi që nuk ka ndryshime thelbësore midis dy shkresave ngase siç tha z. Hoxha shkresa e tij u bazua në shkresën e z. Muja, ndaj u kërkua nga kryetarja me propozimin e **Adem Salihajt** ajo që të kombinoi këto dy shkresa dhe ti dërgoi Qeverisë duke pasur parasysh se çështje thelbësore për këtë projektligj është taniema por edhe qendra mjekësore për këtë qytet. Shaip Muja sugjeroi kryetares që taniema duhet të shndërrohet në projekt, për shkak të vështirësive financiare.

- Rreth konkursit të shpallur për Drejtor dhe Zv. Drejtor në Autoritetin rregullator për shërbimet e ujit u konstatua se aplikacionet dorëzohen nesër në Komision, ndaj kryesuesja propozoi që nesër të mbledhen ato dhe të caktohet mbledhja e komisionit e cila do të intervistoi kandidatët.
- Rreth ftesës për dy ministrat e fushës në komision, **Kryesuesja Duda Balje** njoftoi se MB nuk ka ftuar komisionin në një raportim financiar për media e cila ka qenë e rëndësishme pikërisht për ndarjen financiare që është 3 milion më tepër se në vitin e kaluar, që kanë propozuar zyrtarët e kësaj ministrie gjatë javës së kaluar, ndaj sugjeroi që komisioni të ftoj këta dy ministra por me radhë, me të cilët do ti shqyrtoi problemet që janë aktuale në këto dy ministri por edhe për detyrat sipas strategjisë legislative. Deri në ftesën që do ti bëhet dy ministrave, komisioni do të përgatit pyetjet por edhe vërejtjet dhe assesi nuk do të lejohet me ardhë ministri në komision dhe të reklamoi suksese, ka ndodhur vjet, shtoi **Shaip Muja**, që komisioni të sugjeroi refuzimin e raportimit të MMPH për gjendjen e mjedisit, kurse mbledhja plenare të miratoi atë. Kjo ka ndodhur, ndërhyri **Adem Salihaj**, me presionin e GP të PDK çka nuk duhet lejuar tjera herë raporte joreale dhe mashtruese, ngase gjendja reale tregon se ligji për mjedisin është duke u shkelur, gjithashtu potencoi se kuvendi ka miratua politikat bujqësore bashkë me buxhetin, por nuk do të thotë kjo se komisioni nuk duhet të kërkoj sqarime detale nga MB për efekte, na i ftojme ata sa herë të dojmë, shtoi, ata (Ministri dhe stafi tij) duhet ti përgjigjen komisionit. **Murat Hoxha** dhe **Emilija Redzeqi** u bashkëngjitën diskutimeve me sugjerime të ngjashme sidomos për ndarjen e subvencioneve dhe modelin e tyre etj, kurse për MMPH çështjen e eksproprijimeve rreth pronarëve të vjetër ngase nuk janë regjistruar fare. Kryesuesja premtoi se pyetjet do të formulohen me rastin e thirjes së mbledhjes.

Përgatitur nga stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i Komisionit,
Duda Balje